

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 4 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në krye të herës të theksoj se në parim jam kundër këtij projektligji, për faktin se sa më shumë agjenci, sa më e madhe të jetë qeveria, aq më pak liri e mundësi ka për qytetarët. Po ashtu, dua të them një thënie të famshme: “Kush harron historinë, është i destinuar ta përsëris atë”. Chavez-i ka qenë Presidenti famëkeq i Venezuelës, i vendit më të pasur, nga pesë vendet më të fuqishme për naftë në botë, i cili ndërtoi qeverisjen e tij bazuar në teoritë e majta, si kjo që po diskutojmë sot, duke aplikuar teorinë “Build power from below” (ndërto pushtetin nga poshtë), duke u marrë të pasurve për t’u dhënë të varfërve shëndetësi falas, vendosi taksa të larta. Vendosi t’i quajë mediet private “armiqtë shoqërisë” dhe i dha të drejtën vetes të bënte si të donte me to. Kjo politikë e tij, me gjithë miliardat që vinin nga pasuritë e Venezuelës, nga nafta, krijoi inflacionin më të lartë në historinë ekonomike të vendeve, krijoi krizë kronike ushqimore, protesta, rritje të krimit dhe radhë pafund të njerëzve, në pamundësi për të garantuar minimumin jetik.

Politikën e tij të ndërtimit të pushtetit nga poshtë, ai e zhvilloi duke ndërtuar 17 mijë këshilla komunale popullore; shpenzoi 2 miliardë dollarë për të financuar këto struktura ekstraqeveritare, me idenë për të ndërtuar demokracinë e bazës, demokracinë popullore për t’ia dhënë pushtetin popullit, qytetarëve, por qëllimi final ishte forcimi i kontrollit të tij dhe pushteti, siç shkruan një ushtarak i lartë amerikan, Robert Chandler në librin e tij “Shadow world”, ku i kushton një analizë të thellë të majtës së re globale. E bëra këtë hyrje që secili nga ne të kujtojë se historia vlen dhe eksperimentimi me shtetin, ku Kushtetuta bëhet e pavlerë dhe zëvendësohet me marrëveshje politike, siç ndodh edhe këtu te ne; kur ligji zhvlerësohet dhe zëvendësohet nga i ashtuquajturit “gjykim i popullit”; kur institucionet kthehen në shërbim të politikës dhe shteti njësohet me partinë në pushtet, atëherë fundi është i ditur: mjerim ekonomik, korrupsion e krim, shkatërrim i demokracisë dhe zhvlerësim e shkelje sistematike e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Ne kemi kaluar diktaturën më të egër komuniste, e cila fliste në emër të popullit, dënonte në emër të popullit, internonte në emër të popullit dhe ekzekutonte në emër të popullit. Nuk duhet të harrojmë se mekanizmat që përpilonin këto politika, përveç ish-Sigurimit famëkeq të Shtetit, ishin edhe këshillat popullore të lagjeve, të cilët ishin të parët që denonconin, demaskonin dhe gjykonin armikun e partisë e të popullit. Kontrolli punëtor dhe fshatar iniconte dhe targetonte se kush duhej gjykuar dhe dënuar, kush ishte kundër partisë, kush ishte kundër pushtetit. Ligji ishte një pushtet absolut i diktatorit dhe i partisë-shtet. Të nderuar kolegë deputetë, Ndryshe nga këta shembuj, regjimi që ne të gjithë së bashku zgjodhëm që në vitet ’90 ishte demokracia, e cila bazohet në parimin e shprehur nga Presidenti Lincoln: “Nga njerëzit, për njerëzit, me njerëzit”. Së pari, nga njerëzit. Ky është shqetësimi. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë realitet, kërkon domosdoshmërisht të garantosh pushtet nga populli. Garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, vota e qytetarëve, si baza e respektimit dhe përfaqësimit të vullnetit të qytetarëve në qeverisje. Po ku jemi ne?! Raporti i OSBE/ODIHR-it na ka treguar qartë se jemi akoma vendi i vetëm në Ballkan që nuk bën dot zgjedhje të lira e të ndershme. Kosova dhe Maqedonia na bënë të ulim

kokën me turp, sepse standardi i tyre për zgjedhje të lira e të ndershme, pranimi me moral i humbjes së zgjedhjeve dhe i përgjegjësive nuk krahasohen me ne. Ne nuk kemi shpërfillur, nuk kemi manipuluar, nuk e kemi blerë votën thjesht sepse kështu kemi menduar në një moment, por sepse besojmë se qytetarët e këtij vendi duhet të na dëgjojnë vetëm ne dhe ne duhet të vendosim për ta Së dyti, me njerëzit, ka thënë Lincoln. Ka vetëm një rrugë, dhe kjo garantohet nëpërmjet një republike kushtetuese, ku ndahet qartë roli i shtetit, i qeverisë, i parlamentit, kufizimi, limitimi dhe balancimi i autoritetit të tyre përballë respektimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Prandaj mbas çdo Kushtetute vendosen ligjet, urdhrat dhe rregulloret, që tregojnë qartë përgjegjësitë ligjore, penale dhe administrative të funksionarëve dhe të nëpunësve të shtetit. Nuk është kontrolli i agjencive të partive, siç doni ta bëni ju, por respektimi dhe përgjegjësia përballë ligjit të çdo nëpunësi që garanton ato çka duan qytetarët, liritë dhe të drejtat e tyre. Këto rregulla përcaktojnë detyrimin në kohë për trajtimin e çdo çështjeje dhe kërkesë të qytetarëve. Çdo ndërhyrje nga struktura të ndërtuara nga qeveria, në emër të kontrollit dhe interesit të qytetarëve, as më shumë dhe as më pak synojnë të rritin autoritetin dhe kontrollin e qeverisë, njëson shtetin me pushtetin, shkatërron veprimin kushtetues dhe ligjor, si dhe u jep autoritet pa fund njerëzve të veshur me pushtet.

Në qoftë se ne, të zgjedhurit e popullit, të qytetarëve, që na është dhënë detyra kushtetuese për të kontrolluar qeverinë, nuk kemi asnjë mundësi për ta kontrolluar këtë qeveri, sepse jemi kthyer në vasalë të linjave partiake, jemi ndarë jo në qëllim të qytetarëve, por në qëllim të pushtetit apo interesave politike të partive, ju mendoni se një agjenci, e ndërtuar nga qeveria, do të ushtrojë kontroll dhe do të mund të realizojë atë që ne kemi detyrë kushtetuese? Liria dhe të drejtat janë baza e lumturisë së njerëzve. Liria dhe të drejtat nuk jepen nga qeveria apo nga partia, por janë të dhëna të patjetërsueshme. Sa më e madhe qeveria, aq më e vogël liria, sa më shumë kontroll nga qeveria, aq më pak të drejta kanë qytetarët. Të nderuar kolegë deputetë, Qeveria thotë se ky projektakt pasqyron vizionin dhe synimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës të vendimmarrjes me publikun, si një garanci për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme, brenda aparatit të pushtetit ekzekutiv. Ky projektakt, sipas qeverisë, kërkon të zgjidhë problemet e Agjencisë për Bashkëqeverisje, të emëruar nga qeveria, për të bërë Shqipërinë që duam apo për të ndërtuar platforma të tilla si: “Ankesa ime”, “Biznesi im”, “Fjala ime”, për të përfunduar të “Partia ime” dhe “Pushteti im”. Kush e lexon këtë, do të thoshte mrekulli, se qeveria dhe Rama duan të kontrollohen nga populli; duan, që ata kanë zgjedhur (njerëz të partisë së tyre) në këto institucione të qeverisë, të kontrollojnë çdo nëpunës dhe institucion, në emër të popullit. Jo rrallëherë, edhe në historinë tonë, të nderuar kolegë deputetë, është folur në emër të popullit, dhe jo rrallëherë, pas ideve dhe propagandës së bukur për t’i shërbyer popullit, qëndron qëllimi që t’i shërbehet pushtetit dhe shkatërrimit të interesave të popullit dhe qytetarëve. Kolegë deputetë, Ne nuk mund të shpikim demokraci allashqiptarçe. Ne duhet të bazohemi te standardet europiane. Këto qeverisje kanë përcaktuar me ligj detyrimin për transparencë, përgjegjësi ligjore për t’iu përgjigjur në kohë detyrimeve dhe nevojave të qytetarëve. Venezuela dhe Shqipëria janë nga historitë më fatkeqe, ku është folur në emër të popullit. Po e përsëris edhe një herë: kush harron historinë, është i destinuar ta përsërisë atë.